



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 48, datë 28.12.2020

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIM I RRJETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT “ONE TELECOMMUNICATIONS” SH.A NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 6 STACIONE BAZË TË EMËRTUARA: 1. FRESKU 2 0176; 2. FLLAKA 1603; 3. DURRËS CENTER 1632; 4. RRËSHEN CITY 1552; 5.VLORA CAMP 1663; 6. FARI COMPLEX 0240”, ME VENDNDODHJE NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, MIRDITË DHE VLORË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “One Telecommunications” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit “One Telecommunications” nëpërmjet shtimit të antenave për 6 stacione bazë të emërtuara: 1. Fresku 2_0176; 2. Fllaka 1603; 3. Durrës Center 1632; 4. Rrëshen City 1552; 5.Vlora Camp 1663; 6. Fari Complex 0240”, me vendndodhje në Bashkitë Tiranë, Durrës, Mirditë dhe Vlorë, me zhvillues shoqërinë “One Telecommunications” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet i Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 6 stacioneve bazë, vetëm pas:
 - a. Për stacionin “**Fresku 2_0176**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
 - b. Për stacionin “**Fllaka 1603**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
 - c. Për stacionin “**Durrës Center 1632**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
 - d. Për stacionin “**Rrëshen City 1552**”:



- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Mirditë.
 - e. Për stacionin **“Vlora Camp 1663”**:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë;
 - miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore.
 - f. Për stacionin **“Fari Complex 0240”**:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

~~LEDIA TOTA~~

